

Prof.Dr. Kestrin Katro

Personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të së Drejtës Civile, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 23 vjeçare si pedagoge dhe studiuese.

Pas diplomimit në Drejtësi, në vitin 1994, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me fushën e së Drejtës Civile.

I është akorduar titulli akademik Profesor me 18.09.2015 me vendim të KPA.

Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë: Të drejtën private; Të drejtën e detyrimeve dhe kontratave; Të drejtën tregtare; Të drejtën e falimentimit.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare, në 5 nga të cilat ka qenë drejtuese e projektit.

Ka shërbyer në pozicione drejtuese: 12 vite si zëvendësdekane e Fakultetit të Drejtësisë në periudhën 2008-2020; dy mandate si anëtare e Senatit Akademik në periudhat 2016-2020 dhe 2022 e aktualisht; anëtare e Këshillit të Etikës nga janari 2023.

Ka qenë anëtare e Këshillit të Fakultetit të Drejtësisë në periudhën 2008-2015.

Ka qenë anëtare e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë në periudhën 2015-2019.

Ka marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit për hapjen e disa programeve të studimit në Fakultetin e Drejtësisë në të treja ciklet e studimit.

Ka publikuar mbi 15 artikuj në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe tekstin “E drejtë falimentimi”.

Ka referuar në më shumë se 20 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka qenë drejtuese apo anëtare e bordit shkencor të disa konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ka qenë dhe është udhëheqëse e rreth 10 doktorantëve që nga viti 2012 e aktualisht.

Ka marrë pjesë në komisione të ndryshme *ad hoc* në nivel universiteti apo fakulteti.

Aktualisht është anëtare e Senatit Akademik dhe anëtare e Këshillit të Etikës.

Është titullare e lëndëve “E drejtë e detyrimeve dhe e kontratave” dhe “E drejtë falimentimi” në programin Master i Integruar në Drejtësi, si dhe e lëndës “E drejtë kontraktore e avancuar” në programin Master i Shkencave në të Drejtë Civile.

Gjithashtu po punon për tekstin “E drejtë e detyrimeve dhe e kontratave” për programin Master i Integruar në Drejtësi, si dhe është e angazhuar në dy projekte kërkimore.